



Qendra për Kërkim  
dhe Zhvillim

# **HISTORIKU I INTEGRIMIT TË BASHKIMIT EVROPIAN**



Komisioni Evropian

## **Rreth autorit**

### **Grupi i punës:**

Mirlinda Rusi (M.A. Integrimi Evropian), Drejtore Ekzekutive, QKZH Tiranë, Komola Sako (eksperte në sociologji) QKZH Tiranë, Rozi Beqiri (përpunim informacioni), QKZH Tiranë.

### **Qendra për Kërkim dhe Zhvillim**

QKZH, Tiranë është organizatë jo fitimprurëse e regjistruar në Gjykatën e Tiranës në mars të vitit 2001. Qëllimi i QKZH është të mbledhë, përpunojë dhe analizojë të dhëna mbi ecurinë e sektorit privat dhe publik. Ajo ka si objektiv të ndihmojë institucionet publike dhe komunitetin e biznesit në hartimin e politikave të drejta për zhvillimin e biznesit dhe përmirësimin e menaxhimit të buxhetit.

### **Adresa:**

Qendra për Kërkim dhe Zhvillim  
Rr. Luigj Gurakuqi P.15/1, Sh.1, Ap.1  
P.O.Box: 218/1  
Tiranë, Shqipëri

Tel&Fax: +355 4 230445

Internet: [www.qkzh.org](http://www.qkzh.org)

E-mail: [info@qkzh.org](mailto:info@qkzh.org)

Redaktimi letrar:

Pandora Teta

Faqosja: Rozi Beqiri

Shtypur në shtypshkronjën: albPAPER

ISBN: 978-99927-728-2-9

Ky dokument botohet me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij botimi është e përgjigjegjshme vetëm e Qendrës për Kërkim dhe Zhvillim dhe në asnjë rrethanë nuk pasqyron qëndrimin e Bashkimit Evropian.

# Lënda

---

<b>Parathënie</b> .....	4
<b>Natyra e integritit Evropian</b> .....	5
<b>Metodat e integritit</b> .....	6
<b>Fazat e integritit</b> .....	9
<b>Historia e krijimit dhe zhvillimit të Komunitetit</b> .....	13
<b>Marrëveshjet Evropiane</b> .....	18
<b>Komuniteti Evropian dhe Bashkimi Evropian</b> .....	26
<b>Aktorët</b> .....	29
<b>Qytetarët</b> .....	30
<b>Këshilli Evropian</b> .....	33
<b>Komisioni Evropian</b> .....	35
<b>Komiteti Ekonomiko – Social</b> .....	39
<b>Komitetet Rajonale</b> .....	41
<b>Parlamenti Evropian</b> .....	42
<b>Këshilli</b> .....	45
<b>Gjykata</b> .....	47
<b>Trupi Evropian i Auditorëve</b> .....	50

## PARATHËNIE

Kjo broshurë është përpunuar nga Qendra për Kërkim dhe Zhvillim mbi bazën e përzgjedhjes nga libri i autorit të mirënjohur Nicholas MOUSSIS me titullin në origjinal “Handbook of European Union” nga versioni i pestë i riprodhimit të tij në vitin 1998. Ky autor vazhdimisht ka punuar që nga viti 1968 pranë komisionit Evropian në fushën e ekonomisë dhe ligjit. Duke iu dhënë kjo mundësi, ka qenë prezent në fakte dhe ngjarje të historisë të zhvillimit të Bashkimit Evropian. Nga kjo eksperiencë e veçantë e tij, si dhe nga natyra e librit, i cili është tepër udhëzues dhe vetsqarues për nivelin e studentëve, ne vendosëm që të sillnim këtë eksperiencë pranë auditorit të studentëve shqiptarë. Qëllimi i kësaj broshure është të analizojë një eksperiencë të veçantë në historinë njerëzore: Integrimin Ekonomik të vendeve të ndryshme. Gjithashtu, ajo përshkruan aktivitetet e Bashkimit Evropian në të gjitha fushat dhe ndjek zhvillimin e tyre gjatë viteve deri më sot. Broshura fokusohet në objektivat kryesore, mjetet dhe problematikat deri në arritjen e çdo politike. Kjo eksperiencë është e veçantë për vetë natyrën madhore të qëllimit të saj, që është themelimi i një bashkimi gjithnjë e në rritje i popujve evropiane. Ky bashkim është gjithashtu, i veçantë edhe nga pikëpamja e institucioneve të tij, të cilët nuk kanë ngjashmëri me organizatat e tjera ndërkombëtare. Ne besojmë se kjo broshurë do të jetë e vlefshme për studentët dhe të gjithë ata, të cilët dëshirojnë të kenë një informacion të thjeshtë mbi historinë e integritit të vetë Bashkimit Evropian.

## NATYRA E INTEGRIMIT EVROPIAN

Bukuria e ndërtesës së BE-së qëndron në origjinalitetin dhe thjeshtësinë që e karakterizon atë. Përzgjedhja e formës së ndërtimit i referohet idesë së: “**Integritit vullnetar të vendeve të ndryshme**”, që në të gjithë historinë botërore nuk ka qenë provuar më parë, megjithëse e thjeshtë në koncept, por shumë e vështirë për t’u vënë në jetë. Ajo përfshin krijimin gradual të lidhjeve në dukje të paimagjinueshme dhe të panumërta midis vendeve që marrin pjesë në këtë eksperimente. Ajo është e thjeshtë dhe fleksibël, por ka një pozitë aq të fortë, sa të jetë në koherencë të plotë me luhatjet e situatës ekonomike ndërkombëtare dhe integrimin ekonomik. Përpjekjet për të integruar vende të ndryshme përmes metodave autoritare, kanë dështuar në të shkuarën dhe kanë predispozitën të dështojnë edhe në të ardhmen. Për këtë arsye Integrimi Evropian mund të arrihet vetëm nga vende demokratike dhe të lira nga çdo lloj tiranie, dhe të përgatitura ose të predispozuara për këtë proces. Thjeshtësia e kësaj metode ndërtimi siguron **fortësinë e ndërtesës së Komunitetit**. Marrëdhëniet e vendosura tashmë midis vendeve që marrin pjesë në ndërtim janë kaq solide sa është e pamundur të zbehen më. Komuniteti siguron hapësira të shumta për pranimin e vendeve të tjera Evropiane, ashtu si edhe për shqetësimet e tyre. Këto hapësira janë të pranishme edhe për ndërtimin e kateve që janë stade të tjera shumë të avancuara të integritit Evropian.

Skicat e ndërtimit karakterizohen gjithashtu, nga thjeshtësia dhe origjinaliteti, siç paraqiten nga marrëveshjet e Komunitetit, dhe materialet e ndërtimit, siç paraqiten nga legjislacioni i 2-të në Marrëveshjet. Ne do të analizojmë këto probleme të ndryshme në këtë sesion.

## METODAT E INTEGRIMIT EVROPIAN

Për të patur një ide më të saktë të periudhës së “pas luftës”, të rinjtë e sotëm që nuk kanë përjetuar eksperiencën e tillë si “Evropa e urrejtjes”, “Evropa në luftë”, “Evropa në rrënoja”, le të imagjinojnë një fshat të shkatëruar nga një luftë mizore, me shtëpi pak a shumë të sheshuara, me njerëz të ashpër që përpiqen të mbijetojnë, duke barrikuar dyer e dritare në përpjekje për të shpëtuar mjetet që u kanë mbetur dhe të dashurit e tyre nga vëllezërit armiq. Ata hapin dyert vetëm të lenë të hyjnë mallra që u duhen në shkëmbim të atyre të mirave ekstra që ata prodhojnë. Shohin njëri-tjetrin nga dritarja dhe me rastë flasin me njëri-tjetrin, por pa u përpjekur që të vizitojnë fqinjët e tyre nga frika se do të grinden përsëri dhe do të rikthejnë qejfmbetjet dhe inatet. Prodhojnë të mira materiale me maksimumin e aftësive, në shtëpitë e tyre të vogla dhe në kopshtet e tyre sa një shami dore. Bëhen xhelozë sepse mendojnë se fqinjët e tyre kanë më shumë produkte të një cilësie më të mirë, por që nuk mund t’i blejnë dot. Ata gjithashtu, jetojnë në mëri me njëri-tjetrin.

Më në fund, prej fshatit del në ballkon një njeri i zgjuar dhe kërkon vëmendjen e të tjerëve për t’u mbajtur një fjalim shumë të shkurtër. - Në vend që të jetonin në këtë mënyrë, në mjerim dhe në ankth, ashtu siç po jetonin, në vend që të përgatiteshin për luftë, dhe të izoloheshin në shtëpitë e tyre të shkatërruara, njeriu i zgjuar i ftoi ata të ndërtonin një shtëpi të përbashkët ku të jetonin në paqe, të punonin së bashku dhe t’i tregtonin të mirat materiale më së miri. Në këtë mënyrë, duke kursyer forcat, do të ndihmonin njëri-tjetrit dhe duke i vënë mjetet dhe

njohuritë në dispozicion të të gjithëve, ata mund të bëheshin më të begatë, të fortë dhe mbi të gjitha miq. - Disa i thonë atij se kjo gjë është shumë e vështirë për t'u besuar. –Po!- Tha ai, - dhe ka një pengesë në të gjithë këtë punë, domethënë që, tullat për ndërtimin e shtëpisë së përbashkët duhet të vijnë nga shtëpitë e tyre. Çdo tullë që do të vendoset në ndërtesën e re, në të njëjtën kohë do të rritë të drejtat e tyre mbi të dhe shkëputjen nga shtëpia e vjetër dhe, në njëfarë mënyre, do të zvogëlojë ndjenjën e pronësisë përkundrejt kësaj të fundit. Sa më shpejt që do të përzgjidheshin materialet për të ndërtuar shtëpinë e re, aq më shpejt do të përfundojë shtëpia, ndërkohë që ajo do të hapet si për vizita, ashtu dhe për tregti. Disa e quajtën atë budalla dhe vazhduan të vetë mbylleshin në shtëpitë e tyre. Të tjerë hezituan, duke thënë se në fillim kërkonin të shikonin shtëpinë përpara se të besonin se mund të akomodoheshin në të. Të tjerë sygjeruan një alternativë tjetër që, pa qenë nevoja për një ndërtesë të re dhe marrjen e tullave nga pronat e tyre të dashura, të krijonin mundësinë të hapnin dyert dhe të tregtonin prodhimet e tyre. Të paktë janë ata që besuan fjalët e burrit të zgjuar pa mëdyshje, dhe që pasi aprovuan projektin e tij arkitekturor menjëherë, filluan të sillnin materialet për të ndërtuar shtëpinë komunitare. Ata kështu formojnë katet (stadet e integritit Evropian) dhe ndarjet në çdo kat (politika të përbashkta). Shtëpitë individuale të çdo partneri janë modifikuar në linjë me progresin e ndërtesës së përbashkët. Një ditë ato do të unifikohen nën të njëjtën çati të ndërtesës Evropiane. Ky të tij, të cilët nuk kanë ngjashmëri me organizatat e tjera ndërkombëtare. Projekti i përbashkët është mjaft solid. Ashtu siç është e vështirë të zhvendosësh një tullë nga shtëpitë kombëtare respektive për ta vendosur

atë në ndërtesën Evropiane, po ashtu është e vështirë të zhvendosësh një tullë nga kjo e fundit, pasi të jetë bërë një rregullim ose të jetë marrë një vendim, menjëherë i zbatueshëm në ligjin e Shteteve Anëtare, ose pasi të jetë lëshuar një direktivë, që detyron Shtetet t’i përshtatin ligjet e tyre në formë të tillë, që të arrijnë objektivat kundrejt të cilave janë drejtuar. Këta elementë që janë transferuar ndonjëherë me shumë mundim nga shtëpia kombëtare në shtëpinë e përbashkët, harrohen me kalimin e kohës menjëherë pasi janë vendosur. Po kështu, këta elementë vështirë të dallohen, ashtu siç është e vështirë të dallosh nga një distancë, një tullë të vetme të një ndërtese të madhe. Vendet që kanë vendosur të bashkojnë forcat e tyre për të ndërtuar shtëpinë e përbashkët të Komunitetit Evropian, dhe ata, që i janë bashkuar skemës në një datë më të vonë, kanë pranuar se kanë interesa të majftueshme për t’u bashkuar dhe për t’ia lënë në dorë drejtimin e tyre institucioneve të përbashkëta. Ashtu siç ka thënë Zhan Mone, këshilltar i “burrit të zgjuar”, Robert Shuman: - Bashkimi midis individëve ose komunitetit nuk është i natyrshëm, por ai mund të jetë vetëm rezultat i një procesi intelektual... duke patur si pikë fillimi, vëzhgimin e nevojës për ndryshim. Forca e saj lëvizëse duhet të jetë një interes i përbashkët midis individeve ose komuniteteve.



## FAZAT E INTEGRIMIT

Evropa është ndërtuar tullë pas tulle dhe kat pas kati. Katet janë etapat e integritit ekonomik, të cilat, kur përfundojnë, janë qartësisht të dallueshme, por mund të ndodhë që, gjatë procesit të ndërtimit, një pjesë e katit më të lartë mund të jetë në ndërtim, në një kohë që kati më i ulët të mos ketë përfunduar ende. Kjo ndodh sepse, disa objektiva të një etape të hershme mund të përmbushen vetëm nëse objektivat e stadeve më të larta të integritit, të ndiqen në të njëjtën kohë. Kjo, ndonjëherë, shfaq një nivel disbalance për ndërtesën e Komunitetit, por, nga ana tjetër, nxit protagonistët të përshpejtojnë kohën e ndërtimit, në mënyrë që të përfundojnë ato pjesë të ndërtimit që kanë mbetur të papërfunduara, për shkak të vështirësive të hasura në fillim, ose në raste të tjera, për shkak të hasjeve të interesave sekondare, krahasuar me prioritetet strukturore apo ekonomike.

Në fillim, sidomos pas periudhës “Pas Luftë”, si ajo e vitit 1950, Shtetet ngritën barriera mbrojtëse të larta kundrejt tregtisë së jashtme, si rezultat, edhe kundrejt konkurrencës ndërkombëtare. Këto mund të jenë barriera doganore (tarifat, kuotat dhe standarte që të kishin efekte të njëjta), barriera fiskale (nivele të larta taksimi për importet), barriera administrative (procedura të komplikuar dhe burokratike përsa i përket importeve) etj.

Sikurse regjimet totalitare, edhe ky sistem proteksionist nuk mund të zgjatë në kohë. Ai çon në pakënaqësinë e madhe të konsumatorëve, ku mundësia e të cilëve për të zgjedhur është shumë e kufizuar dhe të operatorëve ekonomik më dinamik dhe më pak të mbrojtur, që shohin

se fusha e aktivitetit të tyre kufizohet mjaft nga këto barrierë. Të dyja palët nxitin qeverinë e tyre të reduktojë proteksionin e jashtëm. Në një organizatë ndërkombëtare, siç është edhe organizata për kooperim dhe zhvillim (OECD), ose Këshilli i Evropës, Shtetet Anëtare marrin përsipër të bashkëpunojnë me partnerët e tyre në fusha të përcaktuara paraprakisht, pa hequr dorë në asnjë mënyrë nga sovraniteti kombëtar. Nga ana tjetër në një organizatë për integrimin ekonomik, siç është Komuniteti i Qymyrit dhe i Çelikut (ECSC), ose Komuniteti Ekonomik Evropian (ECC), deklarojnë vullnetin për t'ia kaluar një pjesë të sovranitetit të tyre kombëtar një komuniteti që qëndron mbi kombet, me fjalë të tjera një sovraniteti të përbashkët. Një model kooperimi ndërqeveritar është krijimi i zonës së tregëtisë së lirë. Në një zonë të tillë, Shtetet Anëtare eliminonë detyrimet që ka importi dhe barrierat doganore kundrejt lëvizjes së lirë të mallrave të prodhuara në territoret e vendeve partnere. Megjithatë, çdo shtet i ruan tarifën e tij të jashtme dhe politikën e tij doganore përkundrejt vendeve të treta. Në kontrast me unifikimin doganor, i cili është dhe hapi i parë në integrimin ekonomik, lëvizja e lirë konsiston jo vetëm tek produktet e prodhuara në territoret e partnerëve të tyre, por të të gjitha produkteve, pavarësisht origjinës së tyre, të vendosura në territorin e vendeve anëtare. Në mënyrë që të administrojnë tarifën e përbashkët doganore, vendet e bashkimit doganor duhet të kenë një politikë tregtare të përbashkët, gjë, që është përfunduar nga gjashtë vende të para anëtare në korrik 1968, një akt i rëndësishëm i kufizimit të sovranitetit kombëtar. Në fund të etapës, të tregut të përbashkët, të gjitha produktet dhe shërbimet do të ofrohen në të njëjtat kushte si në një treg të brendshëm. Kjo do të shihet si një arritje, rezultat

ky i bashkimit doganor të mëparshëm dhe në anën tjetër si rezultat i përafrimit të politikave të përbashkëta.

Përveç **lëvizjes së lirë të mallrave**, gjatë kësaj faze, duhet të ndërmerren hapa që sigurojnë **lëvizjen e lirë të të punësuarve**, të aktiviteteve të mëdha të sipërmarrësve të lirë, dhe të vetëpunësuarve, si dhe lirinë për të ofruar shërbime dhe **lëvizje të lirë të kapitalit**. Në mënyrë që tregu i madh i brendshëm të funksionojë me efektivitet, janë të domosdoshme dhe politikat e përbashkëta (bujqësi, peshkim, etj.) ose politikat mbështetëse komunitare (taksat, kokurenca, etj.) – që përbëjnë një kufizim të mëtijshëm të sovranitetit kombëtar. **Ky shqetësim ka vonuar kompletimin e një tregu të vetëm të Komunitetit të zgjeruar në 12 vende, deri në dhjetor të 1992-shit.**

Edhe pse në një stad të lartë, integrimi ekonomik nuk ka akoma pamjen e një tregu vërtet të mirëfilltë, pasi lëvizjet e kursit të këmbimit dhe rreziku i shkëmbimit mund të krijojnë të tjera barriera për tregtinë, dhe të kufizojnë ndërpenetrimin e tregut financiar dhe krijimin e sipërmarrjeve në vende ku faktorët e prodhimit duken të jenë më të përshtatshëm për aktivitetet e tyre. Në këtë mënyrë, për të krijuar në një treg të përbashkët kushte optimale prodhimi do të ishte e detyrueshme që të kalohet në etapën tjetër të integritimit ekonomik, domethënë me fjalë të tjera, në etapën e **bashkimit ekonomik dhe monetar**. Kjo nënkupton një politikë të përbashkët monetare drejt krijimit të një monedhe të përbashkët si dhe harmonizimin në politika ekonomike. Marrëveshja e Mاستritit i shërbeu këtij procesi.

Përpara përfundimit të plotë të fazës së integritimit, Shtetet Anëtare do të kenë zhvilluar aq shumë lidhje politike dhe ekonomike midis tyre,

saqë do të ndjejnë nevojën që të njehësojnë edhe politikat e tyre jo-ekonomike: **politikën e brendshme dhe gjyqësore**, në mënyrë që të mbrojnë me efikasitet kufijtë e jashtëm nga kontrabandistët, ashtu si edhe nga trafikantët e lëndëve narkotike; **politikat e jashtme**, që gjigandi ekonomik, që kanë krijuar, të ketë zërin e vet të krahasuar me përmasat e tij në Organizatën Ndërkombëtare të Shteteve. Kështu Bashkimi Evropian do të ketë filluar ndërtimin e katit më të lartë të ndërtesës së tij, atë të **Integritit Politik**, i cili mund të zhvillohet më tej në drejtim të integritit të ngushtë social dhe kulturor të njerëzve, dikur të ndarë prej kufijve.

Marrëveshja e Amsterdimit, ka hedhur hapa në këtë drejtim, por një marrëveshje e re, apo një seri marrëveshjesh, do të ishin të nevojshme në mënyrë që të kompletojnë procesin e integritit dhe ta shtrijnë atë më tej në Evropë. Në fakt, Integrimi Evropian është një proces në vazhdim.

## HISTORIA E KRIJIMIT DHE ZHVILLIMIT TË KOMUNITETIT

Në deklaratën e tij historike të 9 Majit 1950, **Robert Shuman**, Ministër i Marrëdhënieve me Jashtë i Francës, deklaroi se “Evropa nuk do të bëhet e gjitha menjëherë, ose sipas një plani të vetëm. Ajo do të ndërtohet nëpërmjet arritjeve konkrete, të cilat në fillim krijojnë një **“Solidaritet de fakto”**. Në këtë mënyrë Shuman parapëlqeu metodën funksionale të integritimit Evropian më shumë se atë kushtetues, e cila **do të bazohet në kushtetutën e një federate**. Kjo do të thotë që, shtetet evropiane, që kishin rifituar sovranitetin e tyre kombëtar pas Luftës së Dytë Botërore nuk do t’u nevojitej të hiqnin dorë prej tij menjëherë dhe në mënyrë të plotë për hir të një shteti federal Evropian. Ata thjesht duhet të hiqnin dorë vetëm nga dogma e pandashmërisë së sovranitetit dhe këtë do ta bënin për pjesë të caktuara të sovranitetit, në fusha të përcaktuara qartësisht. Si shpërblim ata do të fitonin të drejtën e inspektimit të atyre çështjeve të partnerëve që ishin vendosur nën qeverisje të përbashkët, dhe do të kontribuonin në zgjerimin e sovranitetit të tyre. Kjo ishte çështje e kufizimit të vazhdueshëm të kontraditës ekzistuese midis Integritimit Evropian dhe Pavarësisë Kombëtare.

Në deklaratën e tij të 1950-ës, Robert Shuman propozoi krijimin e një tregu të përbashkët në dy sektorë të rëndësishëm ekonomikë, që deri atëherë ishin përdorur vetëm për qëllime ushtarake, domethënë sektori i Qymyrit dhe i Celikut: Kjo nënkuptonte integritimin e Gjermanisë si ekonomikisht, ashtu edhe politikisht, në Komunitetin Evropian të

Qymyrit dhe Çelikut, së bashku me Francën. Ai mbronte idenë e transferimit të sovranitetit një autoriteti më të lartë dhe të pavarur, që do të ushtronte kompetencat e mbajtura më parë nga këto shtete në këta sektorë, dhe do të merrte vendime që do t'i detyronin këto shtete. Me fjalë të tjera, kooperimi i Shteteve Anëtare në këta sektorë duhet të ishte tërësisht i ndryshëm nga ai që deri tani kishte ekzistuar, përfshirë këtu edhe organizatat tradicionale ndërkombëtare.

Edhe pse apeli i bërë nga Ministri i Marrdhënieve me Jashtë iu adresua të gjitha vendeve evropiane, vetëm pesë vende – Gjermania, Italia, Belgjika, Holanda dhe Luksenburgu - dhanë një përgjigje pozitive. Kështu, vetëm gjashtë vende e nënshkruan traktatit që shënonte krijimin e Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut (ECSC) në Paris në 18 Prill 1951. “Evropa e Vogël e të gjashtëve” filloi ndërtimin e saj që prej 25 Korrikut të 1952, datë në të cilën hyri në fuqi marrveshja e ECSC-së. Mbretëria e Bashkuar, nga ana tjetër, donte ndërtimin e një zone të tregtisë së lirë, e cila nuk kërkonte asnjë dorëzim të sovranitetit kombëtar. Detyrimet doganore padyshim do të eliminoheshin midis Shteteve Anëtare, të cilat do të ruanin autonominë e tyre në politikën tregtare përkundrejt te tretëve. Danimarka, Norvegjia, Islanda, Austria, Portugalia, dhe Zvicra e mbështetën këtë argument.

Gjithsesi, funksionimi i tregut të përbashkët në sektorin e çelikut dhe qymyrit tregoi se Integrimi Evropian ishte i mundur dhe i vlefshëm dhe që duhet të përhapej tek të gjitha mallrat. Për këtë, Ministri i Marrdhënieve me Jashtë i të Gjashtë-ve në Mesina, nga data 1-3 Korrik 1955, diskutoi mundësinë e krijimit të një tregu të përbashkët, duke përfshirë të gjitha mallrat dhe një Komunitet të veçantë për energjinë

nukleare. Ata trajnuan një komitet ekspertesh, të kryesuar nga Ministri i Marrdhënieve më Jashtë të Belgjikës, Poul - Henri Spak, të përgatiste një raport mbi çështjen në fjalë. Komiteti prezantoi raportin e vet në 21 Prill 1956, dhe konkluzionet e tij u aprovuan nga Konferenca Ndërqeveritare, e mbajtur në Venecia, në Maj 1956. Ministri i Marrdhënieve me jashtë më pas vendosi të iniciojë negociimet midis gjashtë vendeve, me pikësynimin për të krijuar Komunitetin Evropian të Ekonomisë (EEC), dhe Komunitetin Evropian të Energjisë Atomike (EAEC). Vetëm dhjetë muaj më vonë, në 25 Mars 1957, në një kohë rekord, duke e konsideruar çështjen e bashkimit shumë të rëndësishme, të Gjashtët ishin të aftë të nënshkruanin, në Kapitol Hill në Romë, Marrëveshjen, që vendosi dy Komunitete të reja.

Përpjekjet më të reja britanike për krijimin e një zone shumë më të madhe të tregtisë së lirë Evropiane midis Komunitetit Evropian dhe Shteteve të tjera Anëtare të OECD falimentuan përgjatë vjeshtës 1958, kjo falë opinioneve të ndryshme dhe të papajtueshme që kishin Franca dhe Mbretëria e Bashkuar midis njëra-tjetrës. Kundërpërgjigjja erdhi në 1959 me krijimin e Marrëveshjes së “Vogël” Evropiane të Tregtisë së Lirë (EFTA), ku Mbretëria e Bashkuar, Norvegjia, Suedia, Danimarka, Austria, Portugalia, Islanda dhe Zvicra me mirëkuptim, vendosën që Finlanda të anëtarësohej në një datë më të vonë.

Edhe pse e impresionuar nga suksesi i shpejtë i Komunitetit Evropian, nuk kaloi shumë, përpara se Qeveria Britanike të refuzonte gjatë negociatave. Ishte e kuptueshme që Mbretëria e Bashkuar nuk do të kishte më atë influencë politike të mëparshme, nëse do të donte të luante një rol aktiv vetëm në Komonuelth. Edhe EFTA ta, objektivat e së cilës

ishin ekonomike – në oponencë me Komunitetin Evropian, i cili gjithashtu kishte qëllime politike - lejoi Mbretërinë e Bashkuar të vendosë influencën e saj. Kështu në Gusht 1961, Mbretëria e Bashkuar ju nënshtrua një aplikimi zyrtar fillestar për t’u bërë një anëtare me të drejta të plota në Komunitetin Evropian. Ky shembull u ndoq edhe nga dy anëtarë të tjerë të ETA-s, Danimarka, Norvegjia, e gjithashtu nga Irlanda. Anëtarësimi i këtyre vendeve në fillim hasi në oponencën e Presidentit të Republikës Franceze, Gjeneralit De Gol, i cili ishte ekstremisht mosbesues në aplikimin e Mbretërisë së Bashkuar për asociimin e saj, ai deklaroi këtë qëndrim në mes të negociimit në 1963. Aplikimi i dytë i Mbretërisë së Bashkuar në 1967, ku në të cilën Irlanda, Danimarka dhe Norvegjia ishin përsëri candidate për asociim, nuk u ekzaminua për shumë kohë kjo fal hezitimit të Francës. Çështja e asociimit të këtyre vendeve nuk do të zgjidhej deri në dorëheqjen e Gjeneralit de Gol që pasoi në Prill 1969. Pas shumë negociimeve të mundimshme Traktati i Asociimit më në fund u nënshkrua në 22 Janar 1972. Asociimi i Mbretërisë së Bashkuar, Irlandës dhe Danimarkës dha efekt në Janar 1973, i cili u pasua me referendumin favorizues (Irland, Danimark) dhe ratifikimin nga Parlamenti Kombëtar. Vetëm asociimi i Norvegjisë u pengua me 53.49 % të votave të popullit norvegjes, të cilët dolën në oponencë me anë të referendunit kundrejt asociimit të Norvegjisë në Komunitetin Evropian. Greqia i’u nënshtrua aplikimeve për asociimin në Komunitetin Evropian, në 1975, ndërsa shtete si Portugalia dhe Spanja, në 1977. Greqia u anëtaresua në Komunitetin Evropian në 1 Janar 1981, dhe Spanja me Portugalinë në 1 Janar 1986.



Me nënshkrimin e të vetmit Akt Evropian, në qershor 1998, “Të dymbëdhjetët” vendosën të ndërtonin tregun e tyre të përbashkët në 31 dhjetor 1992. Një vit para kësaj date në dhjetor 1991, ata vendosën në Mastrit, t’i shtonin tregut të përbashkët një bashkim ekonomik dhe monetar, një politikë të përbashkët të marrëdhënieve gjyqësore dhe të brendshme, dhe një politikë të jashtme dhe mbrojtëse të përbashkët, duke e transformuar kështu nga Bashkimi Evropian i Ekonomisë, në Bashkimin Evropian, duke përfshirë një Komunitet të rinovuar.

Që nga fillimi i Janarit 1995, Evropa e “Të dymbëdhjetëve” u bë Evropa e “Të pesëmbëdhjetëve”, me hyrjen e Austrisë, Finlandës dhe Suedisë. Populli i Norvegjisë votoi përsëri kundër anëtarësimit në Bashkim me një mazhorancë prej 52.8%.

Në vitin 2004 dhjetë vende nga blloku ish komunist iu bashkuan klubit Evropian si, Hungaria, Republika Çeke, Polonia, Sllovenia, Sllovakia, Lituania, Letonia, Estonia, Qipro dhe Malta. Në janar të vitit 2007 Bullgaria dhe Rumania u bënë vende anëtare të Bashkimit Evropian.

## MARRËVESHJET EVROPIANE

Këtu do t' i hedhim një sy të përgjithshëm Traktateve më të rëndësishme, dhe atyre të cilët janë përshtatur në përputhje me nevojat e reja duke lejuar vijimin e mëtejshëm të progresit të staveve për ndërtimin e Bashkimit Evropian.

Si u përmend më lartë, Traktati i parë Evropian, ai që krijoi njëherazi Komunitetin Evropian të Qymyrit dhe Çelikut (ECSC), u firmos në Paris në 18 Prill 1951 dhe hyri në fuqi në 25 korrik 1952. Objektivi i tij më i rëndësishëm ishte të eliminonte barrierat e ndryshme të tregtisë dhe të krijonte një treg të përbashkët, ku prodhimi i produkteve të qymyrit dhe çelikut mund të lëvizte lehtësisht në Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, me qëllimin e vetëm që të plotësonte nevojat e popullsisë së këtyre vendeve, pa qenë të diskriminuar prej kombësisë së tyre. Në të njëjtën mënyrë do të veprohej dhe për kapitalet dhe punonjësit e të dy sektorëve. Në mënyrë që të arrihej kjo, Traktati përcaktoi rregulla që kishin të bënin me investimet, ndihmën financiare, prodhimin dhe çmimet, marrveshjet, përqëndrimet, transportin si dhe institucionet e komunitetit duke përfshirë këtu autoritetin e lartë dhe një këshill të veçantë të ministrave, vendimet e të cilit do të ishin të detyrueshme për Shtetet Anëtare. Pavarësisht nga qëllimi i tij i kufizuar, marrveshja e ECSC-se duke qenë shumë ambicioze çoi në krijimin e një asambleje evropiane dhe të një gjykate evropiane. Kur Traktati i ECSC-së përfundoi në 2002, rregullat specifike që mbulonin këta dy sektorë do të inkorporoheshin gradualisht në traktatin e EEC-së. Traktati që shënoi krijimin e Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike (EAEC,

por gjerësisht i njohur si Euroatom- i ) u nënshkrua në 25 Mars 1957 dhe hyri në fuqi në 1 Janar 1958. Qëllimi i tij ishte të krijonte një treg të përbashkët për materialet dhe paisjet nukleare, duke vendosur një legjislacion nuklear të përbashkët, duke futur një sistem supervizimi për përdorimin paqësor të energjisë nukleare dhe standarte të përbashkëta për sigurinë, shëndetin dhe mbrojtjen e sigurisë së popullsisë dhe punonjësve kundër rrezatimit jonik. Çelsi i këtij traktati ishte një program i përbashkët kërkimesh, i implementur në një qendër të përbashkët kërkimesh, i cili do të shërbente për progresin teknologjik dhe stimulim e prodhimit nuklear në Evropë. Me gjithë faktin që Euro-atomi ishte shumë në qendër të vemendjes në kohën e krijimit të tij, ai pati eksperiencën si pozitive ashtu edhe negative, si rezultat i zhgënjimeve në lidhje me perspektiva ekonomike për energjinë atomike dhe nga ambicjet e disa Shteteve Anëtare që donin në fillim të zhvillonin industrinë e tyre nukleare, dhe jo të ndiqnin zhvillimet sociale. Traktati, që shënoi krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian, u nënshkrua në të njëjtën kohë me traktatin e Euro-atomit, në Kepitol Hill në Romë në 25 Mars 1957, dhe hyri në fuqi në 1 Janar 1958. Megjthëse me “Traktatin e Romës” nënkuptohet ai i EEC-së. Për shkak të natyrës së tij dhe qëllimeve, ky traktat dominoi mbi traktatet e tjera evropiane (deri në kohën e Traktatit të Mاستritit). Nëse dy të parët janë specifik, të detajuar dhe strikt “traktate legjislative”, Traktati i EEC ishte një “Traktat Kornizë”. Përveç kushteve automatike” që kishin të bënin më arritjen e bashkimit doganor, e kufizoi veten në një grup objektivash të përcaktuara, kjo për t’i dhënë pika referimi udhëzimeve të përgjithshme të politikës që do të ndiqej në disa fusha të aktiviteit

ekonomik. Për më tepër, ai i ofroi institucioneve të Komunitetit mundësinë për të futur në mënyrë graduale dhe me marrveshje unanime të shteteve anëtare, politika të përbashkëta ose komunitare, të cilat ata i shihnin si themelore për arritjen e objektivave të përcaktuara në hyrje dhe në Artikullin 2 dhe 3. Detyra e rëndësishme që Traktati i Romës u vuri Institucioneve të Komunitetit ishte krijimi i një tregu të përbashkët midis Shteteve Anëtare. Kjo do të përfshinte (a) nevojën e një bashkimi doganor, i cili kishte për qëllim në njërën anë heqjen e detyrimeve doganore, kuotat e importit, pengesat në tregti midis Shteteve Anëtare, dhe në anën tjetër futjen e një takse doganore të përbashkët (CCT) karshi vendeve të treta; dhe (b) zbatimin nëpërmjet harmonizimit të politikave kombëtare dhe katër lirive themelore: **liria e lëvizjes së mallrave, lëvizja e lirë e punonjësve, liria e sipërmarrjes** dhe liria për të ofruar shërbimet nga individ dhe shoqëri të caktuara dhe së fundi **liria e zhvendosjes së kapitalit**.

Megjithëse në hyrje të Traktatit Shtetet Anëtare deklaruan që do të ishin të vendosur për të hedhur bazat e një bashkimi, më të ngushtë midis popujve të Evropës, Traktati në vetvete kishte karakterin e një karte të një tregu të përbashkët. Duhet patur parasysh se Traktatit i EEC-së u konceptua në mënyrë të atillë që të drejtonte marrëdhëniet midis Shteteve Anëtare deri në fazën e krijimit të tregut të përbashkët. Gjithsesi nëpërmjet Artikullit 235 të tij, ai u dha Shteteve Anëtare mundësinë të vepronin në fushat e paparashikuara nga ai (Traktati) duke marrë unanimisht masa të përshtatshme për të arritur një nga objektivat e tij. Kjo i lejoi Shtetet Anëtare të zbatonin një numër të gjerë politikash të Komunitetit pa ndryshuar Traktatin.

Traktatet që shënuan krijimin e Komuniteteve u ndryshuan deri diku në drejtim të kushteve që kishin të bënin me funksionimin e institucioneve nga Traktati lidhur me hyrjen në Komunitetin Ekonomik Evropian të Irlandës, Danimarkës, Mbretërisë së Bashkuar dhe Norvegjisë. Ai Traktat u nënshkrua në Bruksel në 22 Janar 1972 dhe hyri në fuqi në 1 Janar 1973, por vetëm për tre vende, pasi referendumi në Norvegji e përjashtoi këtë shtet nga anëtarësimi.

Paralelisht me krijimin e burimeve të veta të komunitetit nga vendimi i 21 Prillit 1970, Vendet Anëtare u morën vesh që të amendonin Traktatet në mënyre që të rritnin kompetencat buxhetore të Parlamentit. Në fakt, një traktat i parë buxhetor u nënshkrua më 22 Prill 1970 dhe hyri në fuqi në 1 janar 1971, por Parlamenti Evropian e ndjeu se ai nuk ia shtoi kompetencat në mënyrë të mjaftueshme. Komisioni vendosi që Parlamenti kishte të drejtë dhe bëri propozime për një zgjerim të mëtejshëm të kompetencave buxhetore të Parlamentit gjë që çoi në nënshkrimin e Traktatit të dytë buxhetor në 22 korrik 1975 dhe hyri në fuqi në 1 qershor 1977. Përveç krijimit të një institucioni të ri, Trupi i Auditorëve i dha Parlamentit të drejtën ekskluzive për t'i dhënë aprovim Komisionit në lidhje me zbatimin e buxhetit, dhe nëse kishte arsye të rëndësishme, të refuzonte buxhetin të gjithë. Traktatet që themeluan Komunitetet u amenduan edhe njëherë me gjithë klauzolat e tyre instiucionale, nga traktati që i referohej pranimit të Republikës Helene në Komunitetin Evropian të Ekonomisë dhe në Komunitetin Evropian të Energjisë Atomike, nënshkruar në Athinë në 28 Maj 1979. Nga ai Traktat të “Nëntët” u bënë të “Dhjetët” nga 1 Janari 1981. Dhe u bënë dymbëdhjetë nga 1 Janari 1986 si rrjedhojë e aktit të pranimit në

anëtarësim të Spanjës dhe Portugalisë, nënshkruar respektivisht në Madrid dhe Lisbonë në 12 Qershor 1985.

Një amendament i rëndësishëm i Traktatit, i vendosur nga komuniteti Evropian, mori jetë në 1 Korrik 1987 me hyrjen në fuqi të të Vetmit Akt Evropian që plotësonte në veçanti Traktatit e EEC-së. Akti i Vetëm detyronte Komunitetin të adaptonte masa me qëllim vendosjen e progresit në tregun e brendshëm nga një periudhë që shtrihej nga 31 dhjetori i 1992. Në të njëjtën kohë u pagëzua edhe Këshilli i Evropës, kooperimi Evropian në politikën e jashtme si dhe kohezioni social dhe ekonomik midis Shteteve Anëtare. Së fundmi, u konfirmua kompetenca që Komunitetit do të kishte në fusha të ndryshme si: sociale, ambientale, kërkim dhe teknologji. Por ishte Traktati mbi Komunitetin Evropian i firmosur në 7 Shkurt 1992, që shënoi një stad të ri në procesin e krijimit të një bashkëpunimi të ngushtë midis popujve të Evropës. Bashkimi u krijua mbi bazat e Komunitetin Evropian dhe u plotësua nga politika të reja dhe forma kooperimi. Karakteri esencial ekonomik i Komunitetit u tejkalua me qëllim që të lejonte krijimin e një njësie me karakter global. Duke u bazuar në artikullin B të Traktatit, Bashkimi i vendosi vetes një grup objektivash si më poshtë:

- të promovojë progresin ekonomik dhe social që është i balancuar dhe mbështet në veçanti nëpërmjet krijimit të një zone pa kufi të brendshme, nëpërmjet fuqizimit të ekonomisë dhe kohezionit social si dhe nëpërmjet krijimit të një bashkimi monetar duke përfshirë një monedhë të vetme.
- të bëjë të njohur identitetin e vet në arenën ndërkombëtare, në veçanti përmes implementimit të një politike të përbashkët të

jashtme dhe të sigurimit duke përfshirë një politikë të mundshme të përbashkët mbrojtëse, e cila më vonë mund të çonte në mbrojtje të përbashkët.

- të fuqizojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të qytetarëve të Shteteve Anëtare nëpërmjet futjes së konceptit të kombësisë së Bashkimit.
- të zhvillojë kooperim të ngushtë në drejtësi dhe në punët e brendshme.
- të aplikojë në mënyrë të plotë “acquis communitaire” për të gjithë komunitetin.

TEU-ja mbuloi dhe modifikoi Traktatet e mëparshme. Klauzolat që modifikuan Traktatin e Komunitetit të Evropës për Ekonominë, që u rriqajti Traktati i Komunitetit Evropian TEC u mblodhën në nenin G. Ato të Traktatit të Qymyrit dhe Çelikut hynë në nenin H dhe ato që kishin të bënin me Energjinë Atomike formuan nenin I. Në fakt, Traktati mbi EU-në ndan ndërtimin e Evropës në tre kolona ose ndërtesa, që dallojnë nga njëra tjetra nga procesi i vendimmarrjes: Kolona ose ndërtesa kryesore që është **Komuniteti Evropian**, kolona ose **ndërtesa e drejtësisë** ose e marrëdhënieve të brendshme; si dhe kolona ose **ndërtesa e politikës së përbashkët** mbi sigurinë dhe marrëdhëniet me jashtë (CFSP). Komuniteti Evropian – TEU solli ndryshime të mëdha, duke rinovuar disa politika të Komunitetit dhe duke krijuar shumë të tjera si ato të arsimit dhe rinisë, kulturës, shëndetit publik dhe mbrojtjes së konsumatoreve. Bashkimi Evropian u zgjerua në pesëmbëdhjetë Shtete, në 1 Janar 1995, Nëpërmjet Traktateve të pranimit të Austrisë, Suedisë dhe Finlandës, nënshkruar në 24 Qershor

1994 në mbledhjen e Këshillit Evropian mbajtur në Korfuz. Traktati i pranimit të Norvegjisë, gjithashtu, u nënshkrua me këtë rast, por përsëri, populli norvegjez votoi kundër anëtarësimit në Bashkim me një mazhorancë prej 52.8%.

Në 17 Qershor 1997, në Amsterdam, Krerët e shtetit dhe Qeveritë e të pesëmbëdhjetë vendeve të EU-se rishikuan Traktatin e Bashkimit Evropian. **Traktati i Amsterdimit** vendosi një Evropë më demokratike, duke vënë theksin në respektimin e të drejtave të njeriut dhe principeve demokratike nga Shtetet Anëtare. Gjithashtu bëri të qartë çështjen e lëvizjes së lirë të qytetarëve të saj ndërkohë që rriti luftën ndaj krimit të organizuar.

Traktati i Amsterdimit ka katër objektiva të mëdha:

- të vendosë punësimin dhe të drejtat e njeriut në zemër të Bashkimit. Derisa të konfirmohet se Shtetet Anëtare të pranojnë përgjegjësinë primare për punësimin, Traktati i ri dha vëmëndjen maksimale që ata kanë për të vepruar së bashku për të gjetur zgjidhje për papunësinë, që është problemi numër një në Evropë sot.
- të flakë tutje pengesat e fundit të mbetura të lëvizjes së lirë dhe sigurisë së lartë, duke konsoliduar dhe “komunitarizuar” kooperimin e Shteteve Anëtare në fushat e drejtësisë dhe marrëdhënieve të brendshme (kollona e tretë e Bashkimit);
- t’i japë Evropës një zë më të lartë në marrëdhëniet me Botën, duke e bërë Këshillin e Evropës (krerët e qeverive të Shteteve Anëtare) përgjegjës për përcaktimin e strategjive të përbashkëta që zbatohen nga Bashkimi i vendeve anëtare dhe duke zgjedhur



një përfaqësi të lartë për CFSP-në ( Sekretaria e Përgjithshme e Këshillit) duke krijuar Njësinë e Planifikimit të Politikave dhe Paralajmërimin e shpejtë në varësinë e tij;

- të bëjë më eficiente strukturat institucionale të Bashkimit Evropian me pikëpamje për zgjerimin e Bashkimit, veçanërisht kundrejt Evropës lindore , vende të cilat po trokasin në dyert e Bashkimit Evropian.

Traktati i Amsterdamit ka marrë masa për arritjen e këtij objektiv të fundit, kryesisht zgjerimit të procedurave të bashkë-vendimarrjes (Parlamentit/Këshillit), dhe votimit të shumicës në Këshill; por një amendament i ri i TEU-t ose një Traktat i ri do të ishte i nevojshëm në mënyrë që të kompletohej reforma e institucioneve dhe të bëhej e mundur për ata që të punonin në kontekstin e më shumë se njëzet Shteteve Anëtare.

Një karakteristik e përbashkët e traktateve të Komunitetit Evropian është se ato nuk janë traktate konvencionale ndërkombëtare që krijojnë vetëm të drejta dhe detyrime për shtetet. Këto Traktate dhe legjislacioni i derivuar prej tyre përfshijnë të drejta dhe detyrime jo vetëm për vendet anëtare por edhe për shtetasit e tyre. Ky “**efekt direkt**” i ligjit të Komunitetit do të thotë që çdo person mund të kërkojë aplikim të ligjit të Komunitetit i cili kundërshton ligjin kombëtar. Shtetasit gjithashtu mund të invokojnë ligjin e Komunitetit para Gjykatës kombëtare dhe, nëse është e nevojshme para Gjykatës së Komunitetit Evropian.

## KOMUNITETI EVROPIAN DHE BASHKIMI EVROPIAN

Sot dëgjohej të flitet për tre kolonat e Bashkimit Evropian, që janë (1) Komuniteti Evropian (KE), (2) politika e përbashkët e jashtme dhe e mbrojtjes (CFSP)-ja dhe (3) marrëdhëniet e brendshme dhe drejtësia (JHA). Por duhet thënë se imazhi i EU-së si “tre kolona” e minimizon rolin e Komunitetit pasi ai përmban të gjitha politikat e përbashkëta dhe komunitare, të institucionalizuara në skeletin e tri Traktateve origjinale dhe të gjithë legjislacionin e adaptuar mbi bazat e tyre që prej 1952. Bashkimi Evropian do të konceptohej më mirë si një **ndërtesë në ndërtim e sipër**.

Një vështrim më i afërt i imazhit metaforik mbi konstruksionin Evropian tregon që ndërtesa kryesore, ajo e Komunitetit, është e ndarë horizontalisht në kate. Kati i tregut të përbashkët është ndërtuar duke patur për bazë bashkimin doganor.

Ndarjet e çelikut dhe energjisë nukleare, të mbuluara nga ECSC dhe Traktati i Euroatomit,

janë gjithashtu të vendosura në këtë kat të ndërtesës së Komunitetit.

Kati i Bashkimit Ekonomik dhe monetar është ndërtuar në të njëjtin kat me atë të Tregut të Përbashkët dhe për pasojë bën pjesë në ndërtesën e komunitetit.

Disa prej paisjeve dhe materialeve ishin tashmë gati, kjo fal Sistemit Evropian Monetar, dhe lëvizjes së lirë të kapitalit, por Traktati i BE-së ka projektuar planin arkitekturor dhe “memorandumin e mirëkuptimit” që ndërtuesit (institucionet Evropiane dhe shtetet anëtare) kanë nevojë të respektojnë në mënyrë që të ecin përpara në ndërtim.

Ndërtimi vazhdoi edhe pas hyrjes në fuqi të TEU-t, ashtu si në 1 Nëntor

1993 ku hynë në fuqi ndërtesat e CFSP-së dhe JHA-së. Arkitektët ishin të njëjtët –krerët e shteteve kryesore që mbledhen në KE dhe Parlamentin Evropian. Specialistët kryesore janë të njëjtë, Këshilli Evropian, Komisioni dhe Parlamenti Evropian, por mënyrat e punës për ndërtimin e këtyre ndërtesave ndryshojnë nga mënyrat që përdor për ndërtimin e ndërtesës kryesore. Kryesisht nuk është vetëm Komisioni burim i çdo veprimi apo vendimi të ri, Parlamenti Evropian jep mendim por në të vërtetë nuk është angazhuar në procesin e vendim-marrjes, dhe vendimet e marra nuk i janë nënshtruar kontrollit të Gjykatës. Metodatat e ndërtimit të kësaj ndërtese varen shumë më tepër nga kooperimi ndër qeveritar sesa nga bashkeveprimi midis institucioneve. Kjo nuk i pengon këto ndërtesa që janë në ndërtim e sipër që të jenë nën çatinë e BE-së.

“Komuniteti Evropian” ekziston dhe rritet nën çatinë e BE-së. Kjo është e vërtetë gjithashtu edhe për dy Komunitetet e tjera, atij të qymyrit dhe çelikut, dhe atij të energjisë atomike, të cilët zakonisht ngatërrohen me “Komunitetin”. Nuk do të ishte gabim nëse do të flisnim për “komunitet” kur është fjala për çdo gjë që ka ndodhur dhe është ndërtuar para 1 janarit 1993. Është më e saktë të flasim për “komunitetin” kur është fjala për masat e marra pas kësaj date në kohën e fillimit të procedurave të “Komunitet” në bazë të Traktatit të EC-së (por gjithashtu të Traktateve të ECSC-së dhe EAEC-së). Termi “Bashkim Evropian” duhet gjithsesi të përdoret për të gjitha masat lidhur me ndërtesat e reja dhe, në përgjithësi, për projektimin e organizatës së Shteteve Evropiane, të cilat kanë vendosur të krijojnë një bashkim më të ngushtë midis popujve, duke mbuluar marrëdhënie shumë më të gjera se marrëdhëniet ekonomike të qeverisura nga Komuniteti fillestar.

## AKTORËT

Protagonistët e ndërtimit evropian janë në njërin anë organet kyesore të komitetit që në traktate quhen “**institucione**” dhe në anën tjetër **organet konsultative** të cilat do t’i shqyrtojmë më tej sipas radhës me të cilën hynjë në procesin e vendim-marrejs së Bashkimit. Këto janë:

- § Këshilli Evropian që zhvillon marrëdhëniet dhe çështjet evropiane,
- § Komisioni Evropian që bën propozime për veprimet që duhen ndërmarrë,
- § Komiteti Ekonomik dhe Social si dhe Komiteti Rajonal që jep mendimin në lidhje me këto vendime,
- § Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Ministrave që marrin vendimet,
- § Gjykata dhe Trupi i Auditorëve që kontrollon ligjshmërinë e këtyre vendimeve.

Pas këtyre aktorëve qëndrojnë artistët e thjeshtë, që janë të domosdoshëm për të legjitimuar veprimet që ndërmerren nga institucionet demokratike në një kontekst demokratik. Këta artistë të thjeshtë janë **qytetarët e bashkimit**, roli i të cilëve në ndërtimin evropian nuk duhet nënvlerësuar.

## QYTETARËT

**Të gjithë Evropianët marrin pjesë** në ndërtimin e Evropës: shtëpiakët, që mbushin shportën me produktet nga të katër cepat e Bashkimit Evropian; motorristët, që zgjedhin makinën që u përshtatet pa u preokupuar për prejardhjen e saj, punëtorët, që punësohen nga një firmë e komunitetit në shtetin e tyre ose në shtetin, që ka origjinën firma; biznesmenët që vrapojnë përmes kufijve për të mbyllur marrëveshje me partnerët e huaj; studentët, që studiojnë në një vend partner për të mësuar gjuhën e tij dhe kështu të përmirësojnë edukimin e tyre; pensionistët nga një shtet verior, që e kalon gjithë vitin duke ëndërruar për të kaluar pushimet në një shtet të Evropës Jugore; qytetari i një prej këtyre vendeve, që aspron të studiojë nga afër stilin e jetës dhe kulturën e fqinjëve të tij, etj. Të gjithë këta marrin pjesë në ndërtimin e kësaj shtëpie të madhe që quhet Evropë. Përdorimi i të mirave materiale, shërbimeve dhe mundësive të ofruara nga partnerët tanë Evropianë bëjnë ecjen përpara të Evropës. Sa herë që zgjedhim këtë apo atë prodhim ose shërbim ne në mënyrë të pavetëdijshme kontribuojmë në ndërtimin e Evropës. Ne nuk jemi të shqetësuar për rëndësinë e këtyre veprimeve sepse për ne ato janë po aq të natyrshme sa dhe ajri. Imagjinoni për një moment, indinjimin, zemërimin tonë, nëse do të na duhej të humbnim mundësinë për të zgjedhur lirisht mallrat e konsumit dhe të atyre që ofrojnë shërbime të ndryshme. A mund të imagjinohet një qeveri që do të guxonte të na privonte nga ato të mira materiale dhe shërbime që na janë bërë aq të nevojshme, një qeveri që do të guxonte të rindërtonte barrierat e proteksionizmit të së kaluarës?

Nëse nuk mundesh ta imagjinosh atëherë ti beson me plot të drejtë se rrjedha e historisë është e pakthyeshme dhe se ndërtimi i Evropës ka për të vazhduar. Duke qenë me shumë se një spektator i interesuar dhe më shumë se një artist i thjeshtë ju jeni padiskutim një mbështetës i përgatitur, nëse është e nevojshme të mbroji deri në fund ndërtimin e Evropës.

Proçesi i Ndërtimit e ka vënë Evropën në qendër të arenës botërore. Ne jemi të pranishëm në një moment të madh në historinë e njerëzimit, me vetëdije të plot ose jo, në një eksperiencë unike që do të lerë gjurmët e saj në historinë e planetit për një kohë të gjatë, siç është unifikimi gradual dhe i lirë i kombeve, të cilët deri vonë ishin armiq me njeri – tjetrin. Fjala **çelës i kësaj eksperience është liria: liria e lëvizjes së individëve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit**, liria e Shteteve dhe popujve të tyre për t’u bërë pjesë ose jo në këtë Bashkim. Liria politike dhe ekonomike është ujë për llaçin që nevojitet në ndërtimin e Evropës e cila shpejt ose vonë do të akomodojë të gjithë popujt e Evropës, trashëgimtarët e një civilizimi të përbashkët, diversiteti i kulturave, të cilat përbëjnë forcën dhe padurimin e tij. Qytetarët që i duan këto liri janë mbështetës të vetëdijshëm ose të pavetëdijshëm të ndërtimit të Evropës. Asgjë e përjetshme nuk mund të ndërtohej pa dëshirën e Evropianëve për të jetuar në paqe. Për probleme serioze si: papunësia ose lufta kundër terrorizmit dhe krimit, dy qytetarë në tre janë të predispozuar t’ia besojnë fatin e tyre Bashkimit Evropian. Publiku i gjerë Evropian është në favor të projekteve që i japin drejtim problemeve të mprehta të makinerisë evropiane siç janë krijimi i një monedhe të përbashkët, mbrojtja e përbashkët ose politika e jashtme.

Gjithsesi, përvec rreth 650 gazetarëve të akredituar ne Komisionin Evropian, publiku Evropian është ende i paditur ose i keq-informuar rreth ndërtimit të Evropës. Në studimet, “Eurobarometër” të cilat bëhen rregullisht nën mbikqytjen e Komisionit, tre në katër qytetarë thonë se nuk janë mirë-informuar rreth institucioneve dhe politikave të Bashkimit Evropian. Të rralla janë rastet në të cilat temat dhe çështjet e Bashkimit përbëjnë titujt kryesorë në shtypin e shkruar dhe aq më të rrallë janë në radio dhe televizion. Më keq akoma janë krizat dhe pengesat e përkohshme që zenë vend më të madh në shkrimet kryesore, pasi ato janë më sencacionale se sa sukseset e arritura përmes negociimeve të vazhdueshme që gjithsesi prekin jetën e përditshme të qytetarëve, në disa raste ato që përbëjnë lajm janë më shumë ligjet e adaptuara nga parlamentet kombëtare. Le të pranojmë se, çështjet janë të vështira për t’u kuptuar nga publiku i gjerë dhe për arritjen e këtij duhen bërë përpjekje të mëtejshme si nga Bashkimi Evropian ashtu dhe nga Qeveritë për të edukuar qytetarët rreth çështjeve që kanë të bëjnë me Komunitetin.

Duhet theksuar se pikëpamjet e qytetarëve Evropian kundrejt Integritetit Evropian janë shprehur jo vetëm përmes zgjedhjes së drejtëpërdrejtë të parlamentit Evropian, por gjithashtu edhe përmes **parlamenteve kombëtare**, të cilët manifestojnë një interes gjithnjë e në rritje kundrejt ndërtimit Evropian. Në të vërtetë, një Protokoll i Traktatit të Amsterdambit thekson rolin e parlamenteve kombëtare në Bashkimin Evropian.

## KËSHILLI EVROPIAN

Çdo njeri ka parë foton e familjes që bëhet në mbledhjet e rregullta të krerëve të Shteteve dhe Qeverive të Shteteve Anëtare të Komunitetit. Këto takime përbëjnë ato raste të ralla kur Komuniteti qëndron në qendër të vëmendjes për dy ditë me radhë dhe kjo me plotësishtë të drejtë pasi Këshilli Evropian është arkitekti i ndërtimit evropian. Ai bën planet politike për diskutime të mëtejshme dhe zgjidh problemet më të rëndësishme të ndërtimit, i ngritur fillimisht mbi një bazë informale ai shprehet qartë në Artikullin D të Traktatit të Bashkimit Evropian.

Në Samitin e Parisit në 1974 u vendos që Krerët e Qeverive të takohen tre herë në vit, dhe kur të jetë e nevojshme, në këshillin e Komuniteteve. Këshilli i Evropës, që kur u bë i njohur, ka bërë të mundur të bashkojë krerët e qeverive, ministrat e marrëdhënieve me jashtë, presidentin dhe zëvendës presidentin e Komisionit Parlamentar, dhe janë ata që diskutojnë rreth subjekteve me interesa të përbashkët ende të pambuluara nga ndonjë detyrim ligjor, për të hedhur në letër guida dhe për t'i dhënë nxitje zhvillimeve më të mëdha politike dhe institucionale si: Zgjedhjet direkte të Parlamentit Evropian, plotësimin e tregut të brendshëm, traktatin e BE-së. Këshilli Evropian shpesh vepron si një trup që bën thirrje për çështje të rëndësishme politike dhe ekonomike që janë të bllokuara në nivelin ministror.

Këshilli Evropian është i gjithi një forum për shkëmbime të lira dhe jo formale të pikëpamjeve midis liderëve të Shteteve Anëtare si në koordinimin politik (politika të zakonshme dhe të mbrojtjes së jashtme) dhe në problemet e Komunitetit.



Forca e tij është spontaniteti dhe informaliteti, të cilët sjellin një lloj fryme bashkëpunimi midis udhëheqësve politik të Evropës. Pavarësisht nga fakti që ka patur mbledhje të Këshillit të Evropës që nuk kanë patur rezultate të rëndësishme madje në disa raste aspak të tilla, bilanci i punës së Këshillit të Evropës është në përgjithësi pozitiv. Ka zgjidhur një sërë problemesh të cilat kërcënonin solidaritetin dhe progresin e Komunitetit. Ka dhënë nxitje politikave të reja të komunitetit dhe ka vendosur përgjegjësinë kolektive të liderëve të diplomacisë evropiane në lidhje me problemet madhore në Evropë dhe Botë.

## KOMISIONI EVROPIAN

Komisioni Evropian, është rezultat i bashkimit në korrik 1967 të trupave ekzekutive të tri Komuniteteve Evropiane. Numri i pjesëtarëve të tij është rritur hap pas hapi, dhe si rregull Komisioni përbëhet nga dy komisionerë për çdo vend anëtar të madh dhe një për çdo Shtet Anëtar më të vogël. Nenet që nga 156 deri tek 163 tek traktati i EC-së, si të amenduara pas pranimit të tre Shteteve të reja në Anëtarësim, shprehin ndryshimet me Protokollin e zgjerimit, reflektuar në Traktatin e parë të Bashkimit me hyrjen në fuqi të zgjerimit të parë. Komisioni edhe më pas, me shtimin e shteteve është zgjeruar. Ai përpiket t’i përmbushë detyrat e tij plotësisht në mënyrë të pavarur dhe në interesin e përgjithshëm të Komunitetit. Komisioni është forca lëvizëse për ndërtimin e Evropës. Ky **rol iniciativmarrës** i tij vjen ngaqë, brenda kornizës së Traktateve vetëm ai ka të drejtë të bëj propozime të tilla që çojnë përpara propozimet e Komunitetit. Asnjë tjetër dhe asnjë Shtet individualisht s’mund t’a zvendësojë Komisionin në këtë detyrë. Ai vetëm mund të amendojë propozimet e tij, dhe kjo bëhet duke pasur unanimitet në Këshill. Edhe pse përgjatë reflektimeve dhe negociemeve me prezencën e Këshillit, është Komisioni ai që mund të shqyrtojë, të rishikojë propozimet e tij në mënyrë që të inkurajojë lëshime këtu apo aty dhe të arrijë marrëveshje. Komisioni gjithsesi mund të paralizojë procesin e vendim-marrjes së Komunitetit, ashtu si mund ta pezullojë. Brenda një viti ai i paraqet rreth 700 propozime Këshillit. Komisioni luan një **rol normativ** si ruajtës i Traktateve dhe të **“asquis communautaire”** (dmth i gjithë legjislacioni i Komunitetit). Një nga

detyrat më të mëdha është të garantojë aplikime të duhura nga Shtetet Anëtare brenda kushteteve të përcaktuara nga Traktatet dhe Legjislacioni i Dytë. Për këtë qëllim ai ka fuqi hetuese të cilën e ushtron me iniciativën e tij ose në përgjigje të një kërkesë të bërë nga një qeveri ose të një ankese të bërë në mënyrë individuale. Nëse, duke vazhduar hetimin, Komisioni konstaton se kushtet e Komunitetit janë thyer, ai fton Shtetin e ngarkuar që të bëjë komentet përkatëse pas një periudhe parapërgatitore. Nëse Shteti në fjalë nuk përmbush kushtet ose dhe shpjegimi që ai ka përgatitur nuk bind Komisionin, ky i fundit shpreh mendimin e tij të cilin Shteti Anëtar është i detyruar t' i përmbahet brenda kohës së përcaktuar. Dështimi i kësaj të fundit do të çonte që Komisioni t' i referohej trupit gjykues, i cili arbitron çështjet dhe sanksionon parregullsitë e verifikuara nga Komisioni. Më pas kërkon opinione të ndryshme midis Shteteve Anëtare dhe Komisionit, por paanësia e Komisionit nuk është vënë kurrë në diskutim.

Komisioni është gjithashtu dhe **trupi ekzekutiv** i Komunitetit ku luan një **rol administrativ**. Traktatet që janë mbi Komisionin shtrinë fuqinë ekzekutive për të siguruar arritjen e objektivave të dala brenda tyre: arritja e një tregu të përbashkët, kontrolli i rregullave të konkurrencës etj. Por kompetencat e Komisionit janë rritur në mënyrë të qëndrueshme nga ushtrim i fuqive që i janë dhënë, në emër të Shteteve Anëtare, nga Këshilli për implementimin e politikave të zakonshme të Komunitetit. Është Komisioni që ose vetëm ose i ndihmuar nga një komitet i përbërë nga përfaqësues të qeverive, në përputhje me procedurat e Komitetit Këshillues, Komitetit të Menaxhimit, (i cili mund të anulojë vendimet e Komisionit, me një mazhorance të cilësuar të anëtarëve të tij), të

Komitetit Regullues (i cili duhet të aprovojë vendimet e Komisionit, me një mazhorancë të cilësuar të anëtarëve të tij), që implementon vendimet e Këshillit dhe menaxhon buxhetin e Komunitetit dhe në veçanti disa fonde të ndryshme të Komunitetit.

Së fundi, Komisioni luan një rol përfaqësues duke siguruar kështu përfaqësimin e Bashkimit Evropian në vendet e treta dhe në shumë organizata të tjera. Duke vepruar në emër të EU-së dhe institucioneve nga Këshilli, Komisioni negocion marrëveshje tarifash psh: nën Marrëveshjen e Përgjithshme të Tarifave dhe Tregëtisë (GAAT) dhe tani Organizata Botërore e Tregëtisë. ai negocion marrëveshje tregtie, marrëveshje partneriteti dhe marrëveshje mbi pranimin e Shteteve të reja Anëtare në BE.

Komisioni është padyshim një nga trupat ose njësitë ekzekutive më mirë të monitoruara në Botë. Fillimisht është vet-monitorimi i ushtruar së bashku në nivel politik nëpërmjet pranisë së Komisionerëve të autoriteteve të larta nga të gjitha Vendet Anëtare dhe në nivel administrativ përmes përbërjes nga departamentet e Komisionit. Për këtë, Komisioni është zyrtarisht i kontrolluar nga Parlamenti Evropian, i cili mund të japë një notë censure kundrejt atij, dhe t' a detyrojë atë të dorëzohet. Komisioni është jo zyrtarisht i kontrolluar nga Këshilli Evropian i cili, nëse disaprovon iniciativat e tij, mundet gjithashtu të bëj presion për dorëzimin e tij. Kjo s'ka ndodhur kurrë. Në të kundërt, të dy trupat e kontrollit të zgjedhur demokratisht nga njerëzit e Evropës dhe nga Trupi Suprem Politik i Komunitetit, që përfaqësonin 15 qeveri, në raste të ndryshme kanë shprehur kënaqësinë e tyre ndaj punës së dalë nga Komisioni.

## KOMITETI EKONOMIKO – SOCIAL

Komiteti Ekonomiko - Social (ESC) është trupi zyrtar që bën të mundur që institucionet e Komunitetit t'a vlerësojnë dhe t'a kenë parasysh, kur përgatitin vendimet e Komunitetit, në interes të grupeve të ndryshme sociale dhe ekonomike. Anëtarët e tij, që janë emëruar nga Vendet Anëtare dhe piketuar nga Këshilli, pas konsultimit me Komisionin, duhet të sigurojnë një përfaqësim të gjerë të kategorive të ndryshme të jetës ekonomike dhe sociale. Te 222 anëtarët e ESC-së janë të ndarë vullnetarisht në tre grupe:

grupi i punëdhënësve i njohur si **grupi i parë**, i cili është i përbërë nga përfaqësues të industrisë, institucione bankare ose financiare, federatave të operatorëve të transportit etj;

**grupi i dytë** i punonjësve, i cili është i përbërë më së shumti nga bashkime të organizatave të tregëtisë; dhe

grupe të ndryshme interesash, i njohur si **grupi i tretë**, i cili përfshin përfaqësues të bujqësisë, sipërmarrje të vogla dhe të mesme, profesione, konsumatore, shoqëri dhe organizata që përfaqësojnë grupe të ndryshme interesi, si familja apo lëvizja ekologjike.

Komiteti duhet të këshillohet me Këshillin në disa fusha të vendosura nga Traktati i BE-së. Më së shumti, ESC-ja mund të japë një opinion me iniciativën e tij kur e konsideron këtë të fundit si një veprim të duhur. (Art. 198 EC). Nëse ato kërkohen nga Komisioni ose nga Këshilli ose i japin me iniciativë të tij, Opinionet e Komitetit nuk janë të detyrueshme për institucionet. Gjithsesi, Komiteti luan rolin e një forumi në të cilin pikëpamjet e kategorive të ndryshme socio-profesionale, dhe jo

argumentet me natyrë kombëtare, shprehen në mënyrë zyrtare dhe ballë-për-ballë. Këto opinione reflektojnë shqetësimet e operatorëve ekonomik dhe japin të dhëna të vlefshme për argumentet e kundërta, për divergjencat mbi interesa të ndryshme dhe për mundësitë për të arritur marrëveshje në nivel Komunitar. Për këtë arsye Komisioni ndryshon propozimet e tij për të marrë parasysh pozicionin e shtresave të ulta të Komitetit. Në këtë mënyrë Komiteti influencon vendimet e Komunitetit, si dhe bashkangjit operatorët ekonomik të cilët janë padiskutim të interesuar për efektet praktike të masave të marra nga Komiteti kundrejt realitetit Evropian.

## KOMITETET RAJONALE

Traktati mbi Bashkimin Evropian pranon zyrtarisht ndryshimet rajonale mbi rolin e luajtur nga rajonet në Komunitet përmes krijimit të një komiteti këshilluesi i përbërë nga përfaqësues lokal dhe rajonal. (Art.198a EC). Të 222 anëtarët e Komitetit dhe një numër i barabartë me anëtarë alterantivë janë vendosur për katër vjet nga Këshilli, të cilët veprojnë unanimisht. Komiteti i Rajoneve duhet të këshillohet nga Këshilli ose Komisioni mbi çështje të lidhura kryesisht me linjat e punësimit, legjislacionit mbi çështje sociale, ambjentit, edukimit, trajnime, kulturë, shëndet publik. Ky komitet mund të këshillohet në të gjitha rastet e cilësuar nga ai si të përshtatshme nga një ose dy institucione, në veçanti ai që ka të bëjë me kooperimin ndërkufitar .

Gjithashtu mund të japë vullnetarisht një opinion të tij kur konsideron që interesat rajonale janë në rrezik. (Art. 198 c). Komiteti Rajonal përfshin autoritete rajonale dhe lokale në procesin e vendim-marrjes dhe flet në emër të tyre në të gjitha politikat që shqetësojnë rajonin.

## PARLAMENTI EVROPIAN

Përgjatë viteve të para të ndërtimit Evropian, Anëtarët e Parlamentit Evropian janë vendosur nga parlamentet kombëtare dhe duhet të jenë anëtar të tyre. Megjithëse u kushtëzua nga Traktatet e Parisit dhe Romës, zgjedhejet e Parlamentit Evropian nga votimi direkt e i përgjithshëm u realizua 20-25 vjet pas nënshkrimit të tij, në qershor 1979.

Numri i anëtarëve të Parlamentit Evropian është rritur me zgjerimin e suksesshëm të Komunitetit dhe tani të Bashkimit Evropian. Pas zgjerimit të fundit numri i vendeve është rritur në 626 vende. Gjermania ka 99 vende, Franca, Mbretëria e Bashkuar dhe Italia kanë 81 vende secila, Spanja 60, Holanda 25, Belgjika, Greqia, dhe Portugalia 24, Suedia 22, Austria 21, Danimarka dhe Finlanda nga 16 vende secila, Irlanda 15 dhe Luksenburgu 6 vende.

Zgjedhjet e drejtëpërdrejta e bënë Parlamentin Evropian, Asamblenë e parë funksionale evropiane dhe konsoliduan rolin e saj në ndërtimin e Evropës. Nga Traktati origjinal, Parlamenti ka rol vetëm këshillues, dhe nuk ka pushuar së rrituri ky rol, si rezultat i rritjes së influencës politike që ka arritur ta sigurojë gradualisht.

**Aktualisht ai ushtron katër funksione: legjislativ, buxhetor, politik, supervizues.**

Detyra e parë e Parlamentit nën Traktatin e vendosur nga Komunitetet, atë të këshilluesit, me anë të së cilit Parlamenti jep opinionin e tij mbi propozimet e Komisionit, u përforcua nga Akti i vetëm i 1987, i cili futi një procedurë bashkëpunimi dhe nga Traktati i Bashkimit Evropian, që shtoi një procedurë bashkëvenduese. Atikulli 138b thekson



pjesëmarrjen e Parlamentit Evropian në një proces që çon në adaptimin e akteve të komunitetit përmes ushtrimit të kompetencave të tij nën procedurat e hedhura në Artikiullin 189b dhe 189c (**bashkëvendim dhe bashkëveprim**) dhe përmes dhënies së aprovimit të tij në disa fusha të legjislacionit ose dhënies së opinioneve.

Ashtu siç thamë më lartë nën titullin e procesit të vendim-marrjes së komunitetit, aplikimi i procedurës së bashkë-vendimit u shtri në shumë nivele të reja dhe procedura në vetvete u thjeshtëzua në Amsterdam. Veç kësaj, Parlamenti ka të drejtën të jap ose të refuzojë aprovimin e tij për sa i përket disa konkluzioneve për disa marrëveshje ndërkombëtare, pranimin e Shteteve të reja Anëtareve dhe fondeve strukturore e kohezive. Megjithëse të ndryshme nga kompetencat e Parlamentit Kombëtar, kompetencat legjislative të Parlamentit Evropian rriten pas çdo rishikimi të Traktateve.

Përsa i përket **funksionit buxhetor**, Parlamenti, në bazë të traktatit të dytë buxhetor, të 22 korrikut 1975, ka për detyrë të japë votën e tij për shpenzimet nga buxheti i Komunitetit. Është praktikisht Parlamenti ai që në fund të procedurës së rregullimit me Këshillin, adapton ose refuzon buxhetin e propozuar nga Komisioni. Në këtë mënyrë ai ushtron një kontroll demokratik mbi burimet e veta.

**Funksioni politik** i parlamentit është gjithashtu esencial. Ai përfaqëson 370 milion qytetarë dhe duke qenë një forum Evropian tipik, Parlamenti është në fakt kontraktuesi më i madh për ndërtimin e Evropës.

Ai i bën thirrje protagonistëve të tjerë, siç janë Komisioni dhe Këshilli, për të zhvilluar ose për të ndryshuar politikat ekzistuese ose për të iniciuar politika të tjera që kanë të bëjnë me: politika transporti, ambjenti,

të drejtat e punonjësve, të drejtat e njeriut në Botë. Ky funksion i Parlamentit Evropian u pagëzua nga Traktati mbi Bashkimin Evropian, i cili i jep atij të drejtën të kërkojë që Komisioni të paraqesë propozimet e duhura për çështje për të cilat kërkohet nxjerrja e një akti të komunitetit (Art.138b TEC). Në lidhje me disa raporte të Komisionit, Këshilli Evropian i raporton Parlamentit Evropian për çdo mbledhje të tij, dhe çdo vit për progersin e arritur nga Bashkimi.

**Funksioni monitorues** i Parlamentit është ushtruar në kushte specifike përkundrejt Komisionit. Nën kushtet e Traktatit Komisioni i përgjigjet vetëm Parlamentit, për të shmangur këkesat apo dëshirat e qeverive të vendeve anëtare.

Komisioni duhet t'i japë llogari Parlamentit Evropian, mbron pozicionin e tij para Komisionit Parlamentar dhe në sesionet plenare, dhe i paraqet Parlamentit çdo vit një Raport të Përgjithshëm mbi aktivitetet e Bashkimit Evropian. Parlamenti dhe anëtarët e tjerë të komisionit janë të varur si një trup që i përket një votë aprovimi nga Parlamenti Evropian. Mandati i Komisionit është rritur deri në pesë vjet që të përputhet me mandatin e Parlamentit.

Parlamenti Evropian cakton një Gjykatë me kompetencën për të kontrolluar ankesat nga çdo qytetar i Bashkimit ose nga çdo person fizik ose juridik që është rezident në një prej Vendeve Anëtare dhe ka shqetësimin mbi keq administrimin e aktiviteteve të Komunitetit ose institucioneve.

## KËSHILLI

Këshilli i Bashkimit Evropian, i përbërë nga Ministrat e Shteteve Anëtare dhe që zakonisht quhet Këshilli i Ministrave ose thjesht Këshilli, është **institucioni kryesor vendim-marrës** i Bashkimit. Ai i vetëm, në disa raste, ose me Parlamentin Evropian, në disa fusha, adapton instrumenta të legjislacionit sekondar mbi propozimet nga Komisioni. Në praktikë, vendime të rëndësishme merren **unanimisht**, në rastet në të cilat vota e vendeve të vogla është po aq e fuqishme sa vota e vendeve të mëdha dhe çdo vend mund të bllokojë procesin e Komunitetit, ose nga një **mazhorancë e kualifikuar**, nën kushtet e shpjeguara në fillim të procesit vendim-marrës të Komunitetit.

“Këshilli” i cili referohet në formën e tij abstrakte, ka në të vertetë disa **Këshilla të specializuara**: Këshilli i Ministrave të Bujqësisë për marrëdhënie Ekonomike dhe Financiare, për Transport, për Industri, etj. Çdo këshill është i përbërë nga Ministra kompetentë mbi çështjet në fjalë. Sekretariati i Këshillit ka Drejtorinë e tij. Gjithashtu çështjet diskutohen nga Ministrat përgjegjës për to, vendimet mund të merren nga çdo Këshill i çfarëdoshëm, dhe ky është zakonisht Këshilli i “Marrëdhënieve të Përgjithshme”, i cili sjell së bashku Ministrat për Marrëdhëniet me Jashtë. Këta të fundit, deri në një farë shkalle konsiderohen përfaqësuesit më të “mëdhenj” të Shteteve Anëtare në Këshill.

Presidenca në Këshill ndryshon çdo gjashtë muaj nga një shtet në një tjetër në rend alfabetik, dhe është Ministri i vendit që mban presidencën që kryeson çdo takim të Këshillit.

Roli i Këshillit Presidencial, i asistuar nga Sekretariati i përgjithshëm, është të ribashkojë të gjitha interesat e përbashkëta kombëtare me interesat e Komunitetit.

Një pjesë e rëndësishme në përgatitjen e kompromiseve luhet nga një komitet që konsiston në Përfaqësues permanent të Shteteve Anëtare (COREPER), i cili është përgjegjës për përgatitjen e punës së Këshillit dhe për realizimin e detyrave të dhëna atij nga Këshilli (Art. 151 EC). Kur një propozim i Komisionit ose memorandum i është paraqitur atij, Këshilli i delegon ekzaminimin e tij Komitetit përfaqësues Permanent. Duke vepruar si boshti kryesor i rafsheve politike dhe ekonomike. COREPER përbëhet nga dy pjesë COREPER Pjesa1, që është e përbërë nga përfaqësues dhe drejtues të përhershëm që ekzaminojnë pyetje teknike në përgjithësi, dhe COREPER, pjesa e 2-të, që përbëhet nga Ambasadorë dhe që merren me çështje politike në përgjithësi. Sekretariati i përgjithshëm i Këshillit asiston COREPER-in dhe grupet e punës në realizimin e detyrave të tyre, dhe Komisioni Evropian merr pjesë në të gjitha takimet për të sqaruar pozicionin e tij.

## GJYKATA

Detyra e përgjithshme që i është vendosur Gjykatës së Komunitetit Evropian është të sigurojë që ligji është zbatuar në mënyrë uniforme në interpretimin dhe aplikimin e traktatit, të akteve ligjore dhe të vendimeve të adaptuara nga Këshilli dhe Parlamenti ose nga Komisioni. Në një grup Shtetesh ligjet e përbashkëta nëse do të kontrollohen vetëm nga gjykatat kombëtare, mund të interpretohen dhe zbatohen ndryshe nga një vend në një tejtër, për pasojë ligji i Komuniteti nuk mund të zbatohet në mënyrë uniforme. Ekzistenca e Gjykatë Supreme të Komunitetit, bën të mundur një interpretim koherent dhe uniform të ligjit të Komunitetit, dhe siguron përmbushjen e detyrimeve nga të gjitha Shtetet Anëtare dhe qytetarët e tyre. Në rastin e zbatimit të ligjeve të reja vërehet tendenca për të interpretuar atë ligj në interes të shtetit anëtar. Gjykatatësit kombëtarë, të cilët janë gjykatës të rangut të parë të rregullave dhe sjelljes, lidhur me ligjin e Komunitetit, në rastet kur ky ligj është i përfshirë, mund t'i drejtohen gjykatës me anë të një kërkesë për rregulla preliminare që të pozicionohet në interpretimin ose në analizimin e vlefshmërisë së kushteve të Komunitetit.

Përgjatë vendimeve të tij preliminare, Gjykata luan rolin e këshilluesit ligjor, opinionet e të cilit janë detyruese për palët e angazhara. Kërkesa për një vendim preliminar është vlerësuar nga Gjykata kombëtare dhe stimulon bashkëpunimin midis atyre dhe EU-së.

Në fushën ligjore gjykata rishikon ligjshmërinë e veprimeve të komunitetit. Nëpërmjet procedimeve ajo tenton të anullopë ato veprime të institucioneve që janë në mospërputhje me kushtet e traktatit ose frymës së tyre.

Procedura të tilla mund gjithashtu të fillojnë nga Shtetet Anëtare, individë, apo nga një tjetër institucion i Komunitetit. Kështu për shembull, në Shtator 1982 Parlamenti Evropian ngriti padi për mos veprim kundrejt Këshillit që nuk arriti të vendosë kuadrin për politikën e përbashkëta të transportit.

Gjykata gjithashtu ka juridiksion të vendosë mbi procedimin ndaj Shteteve Anëtare, të cilat nuk përmbushin detyrimet që u përkasin, të vendosura këto nga Traktati ose nga Legjislacioni Sekondar. Procedimet për shkelje mund të jepen nga institucione të Komunitetit (në praktikë nga komisioni), nga një Shtet Anëtar ose nga një individ. Referimi i Komisionit tek Gjykata është faza e fundit e procedurave për shkelje, fazë që vjen fill pas një note vërejtjeje formale të pasuksesshme ndaj një Vendi Anëtar nga Komisioni.

**Konfliktet që hyjnë brenda juridiksionit të pakufizuar të gjykatës** kanë të bëjnë kryesisht me rastet e mospërmbushjes së ligjit ose me interpretimin e rregullave të Komunitetit për konkurrencën. Gjykimet e Gjykatës reflektojnë vitalitetin e Ligjit të Komunitetit. Ato rforcojnë fuqinë e ligjit dhe i japin atij autoritetin e nevojshëm kundrejt qeverive, gjykatave kombëtare, parlamenteve dhe qytetarëve. Përmes gjykimeve dhe interpretimeve të tij gjykata inkurajon nxjerrjen e një ligji të vërtetë Evropian prej të cilit varen të gjitha Institucionet Evropiane, Shtetet Anëtare, Gjykatat Kombëtare dhe çdo individ.

Duke iu referuar Aktit të vetëm, në 24 Tetor 1988 Këshilli adaptoi, me kërkesë të Gjykatës, një Vendim që vendosi: Një **Gjykatë të shkallës së parë** (CFI) të Komunitetit Evropian. Kështu CFI-ja u pagëzua nga Traktati i Bashkimit Evropian, neni 16 e ratifikoi Gjykatën. Kjo Gjykatë

u çlirua nga shqyrimi i fakteve në fusha komplekse për t'ju përkushtuar vetëm detyrave të saj, në lidhje me sigurimin e një interpretimi uniform të ligjit të Komunitetit. CFI-ja ka juridiksion në të gjitha veprimet e bëra nga persona fizikë ose juridikë dhe në raste të lidhura veçanërisht me bujqësinë, peshkimin, fondet evropiane (rajonale, sociale), transportin dhe mbështetjen e shtetit. Gjykimet e CFI-së të përbërë nga 15 anëtarë dhe me të drejtë të njëjtë në asamble, mund të formojnë subjektin e apeleve, të besueshme nga pikëpamja ligjore, ndaj gjykatës.

## **TRUPI EVROPIAN I AUDITORËVE**

Numri i anëtarëve të trupit të Auditorëve është i njëjtë me numrin e Shteteve Anëtare të Komunitetit. Ata zgjidhen nga Këshilli unanimisht pas konsultimeve me Parlamentin Evropian. Trupi ekzaminon llogaritë e çdo shpenzimi administrativ dhe të ardhurave të Komunitetit dhe të gjithë institucioneve të vendosura në Komunitet, si për shembull Qendra Evropiane e Trajnimit, Fondacioni Evropian për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës dhe Punësimit.

Trupi i Auditorëve verifikon nëse të ardhurat janë marrë dhe shpenzuar në mënyrë ligjore dhe bën vëzhgime në menaxhimin financiar të Buxhetit të Komisionit, veçanërisht në pjesën e Komisionit. Trupi i Auditoreve gjithashtu mund të vëzhgojë në mënyrë specifike çështje dhe të jap një opinion me kërkesë të një institucioni Evropian. Së fundi, mund të hetojë Shtetet Anëtare në lidhje me veprimet që këto të fundit kanë kryer në emër të Bashkimit, si mbledhja e detyrimeve doganore dhe qeverisja e fondeve të alokuara të fondit Evropian të sigurisë dhe të Subvencioneve Bujqësore Evropiane, nga fondi i garantuar. Raportet e veçanta dhe specifike të Trupit të Auditorëve janë pranuar të jenë një kontribut i vlefshëm për debatet parlamentare në aprovimin që i duhet dhënë Komisionit për ekzekutimin e buxhetit. Roli i Trupit të Auditorëve është një pasojë direkte e zhvillimit të disa politikave të përbashkëta dhe të Komunitetit.